

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ELBASAN

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan**, me objekt: *“Për zbatimin e procedurës ligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.09.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 181, datë 26.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 767/14, datë 26.12.2014, i ka rekomanduar z. Altin Ago, Regjistruesi i ZVRPP Elbasan, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 18 raste, ka bërë regjistrimin e pasurive e në mungesë të procesverbalit të marrjes në dorëzim të pronës, veprime këto në mospërputhje me nenin 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”* dhe pikën 9.4, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 *“Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”*, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 *“Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”*, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë sipas pasqyrës në Raportit Përfundimtar të Auditimit deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

2- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 2 raste, ka bërë regjistrimin e pasurive e në mungesë të vendimit të komisionit për shpërndarjen e pasurive të kooperativës bujqësore dhe kontratës së marrëdhënieve me truallin, veprime këto në mospërputhje me nenin 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”* dhe pikën 2.1 dhe 2.3, të rregullores 184, datë 08.08.1999 *“Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”*, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 *“Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”*, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 1/245+1-N, volum 23, faqe 150, ZK 8524 dhe pasurinë nr. 61/38, volum 7, faqe 225, ZK 1258, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

3- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 3 raste, e ka bërë regjistrimin e pasurive e në mungesë të procesverbalit të marrjes në dorëzim të pronës, veprime këto në mospërputhje me nenin 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”* dhe pikën 9.4, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 *“Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”*, të ndryshuar.

Rekomandim Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 *“Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”*, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr.

5/138, volum 23, faqe 187, ZK 8524; pasurinë nr. 6/28, volum 24, faqe 61, ZK 8524; pasurinë nr. 132/7/9, volum 7, faqe 216, ZK 3764 dhe pasurinë nr. 1/232+1-1, volum 24, faqe 58, ZK 8524 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

4- Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Elbasan regjistrimin e pasurisë nr. 13/152, truall me sipërfaqe 497,60 m² e ka bërë duke regjistruar më shumë 346,70 m², veprime këto në mospërputhje me VKM nr. 200, datë 19.02.2009 “Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimitin e oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar”, të ndryshuar. **Rekomandim:** Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 13/152, volum 25, faqe 139, ZK 8522, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

5- Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Elbasan regjistrimin e pasurisë nr. 10/156, truall me sipërfaqe 779,20 m² dhe të pasurisë nr. 4/22, truall me sipërfaqe 300 m² e ka bërë në mungesë të AMTP dhe planvendosjes, veprime këto në mospërputhje me aneksin 1, të VKM nr. 200, datë 19.02.2009 “Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimitin e oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar”, të ndryshuar dhe kreu i IV-tër, pika 9, të Rregullores nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 10/156, volum 25, faqe 204 dhe pasurinë nr. 4/22, volum 25, faqe 199, ZK 8522, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajt Shkurt 2015

6- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 9 raste, ka bërë regjistrimin e pasurive me Akti Marrje Toke në Pronësi të fotokopjuar dhe të pa njehsuar me origjinalin. Në 6 raste, ka bërë regjistrimin e pasurive në mungesë të certifikatës së përbërjes familjare datë 01.10.1992. Në 3 raste, ka bërë regjistrimin e pasurive pasi kufizimet e AMTP-ve nuk përputhen me kufizimet e plan rlevimit të hartuara nga topografi me licencë.

Veprimet më sipër, vijnë në mospërputhje me neni 43, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, shkronjën “dh” pika 1, të UKM nr. 2 datë 08.04.2009 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP)” dhe pikën 3 kreu i VI-tër, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 80/14/2, volum 8, faqe 3, ZK 1742; pasurinë nr. 160/10/1, volum 8, faqe 25, ZK 3633; pasurinë nr. 23/1/22, volum 5, faqe 34, ZK 1258; pasurinë nr. 20/52, volum 8, faqe 19, ZK 1258; pasurinë nr. 112/2, volum 3, faqe 47, ZK 2511; pasurinë nr. 240/2, volum 3, faqe 35, ZK 2511; pasurinë nr. 106/3/1, volum 4, faqe 77, ZK 2876; pasurinë nr. 145/6/2, volum 4, faqe 104, ZK 2876; pasurinë nr. 10/6/4, volum 4, faqe 75, ZK 2876, pasurinë nr. 27/59/1, volum 9, faqe 2, ZK 2876, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

7- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 2 raste, të regjistrimit të pasurive të paluajtshme vresht me sipërfaqe 15,000 m² dhe pemëtore më sipërfaqe 20,000 m², i ka regjistruar këto sipas AMTP-ve. Komisioni i Ndarjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Elbasan, me vendim nr.

1, datë 23.05.2001, i ka kërkuar ZVRPP Elbasan, që 37 familjeve të fshatit Lugaj, t'u hiqet toka e marrë me AMTP, pasi kanë marrë tokë mbi normë. Nga ZVRPP Elbasan, nuk është zbatuar vendimi i Këshillit të Qarkut, duke kryer regjistrimin e pasurive vresht me sipërfaqe 15,000 m² dhe pemëtores me sipërfaqe 20,000 m², për këto pasuri ka lëshuar certifikatë pronësie. AMTP-të dhe planrilevimet kanë mospërputhje në kufizimet përkatëse.

Veprimet mësipërm, vijnë në mospërputhje me nenin 23, 24 dhe 25/a të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" me shkronja "a" dhe "b" pika 1, të UKM nr. 2 datë 08.04.2009 "Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP)" dhe pikën 1/1.2 kreu IV, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 40, 49, 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", duke u bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë nr. 112/3, volum 3, faqe 48 me sipërfaqe 15000 m² dhe për pasurinë 129/1, volum 3, faqe 36, sipërfaqe 20000 m², ZK 2511, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

8- Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Elbasan ka regjistruar pasurinë nr. 273/22/3, tokë arë me sipërfaqe 760 m² pa dëshmi trashgimnie dhe pa aktin noterial, veprime këto në mospërputhje me nenin 42, të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, UKM nr. 2, datë 12.9.2012 "Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga ZRPP dhe procedurat për nxjerrjen e urdhrit të regjistrimit" dhe Rregulloren nr. 184, datë 04.08.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 273/22/3, volum 6, faqe 66, ZK 2163, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

9- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 2 raste, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme me AMTP të cilët janë pa kufizime dhe të pa konfirmuara nga Këshilli i Qarkut Elbasan, veprime këto në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar dhe pikën 3, të Udhëzimit nr. 2, datë 08.04.2009 "Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme të fituara me Aktin e Marrjes së tokës në pronësi".

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 42, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 184/50, volum 9, faqe 151 dhe pasurinë nr. 19/1/1, volum 9, faqe 131, ZK 1146, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Menjëherë

10- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 11 raste, në zonën urbane të fshatit Bradashesh, truallin dhe oborrin e ka regjistruar në pronësi të poseduesit, ndërsa trualli duhet të ishte regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme në Seksionin "E" në "Përdorim", veprime këto në mospërputhje me pikën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", me pikën 12.1, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar dhe me nenin 10, të Dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë sipas pasqyrës në Raportin Përfundimtar të Auditimit, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

11- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan ka regjistruar pasurinë nr. 20/213, truall me sipërfaqe 233 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 90 m², në kundërshtim me vendimin nr. 1, datë 25.01.2007, të KRRT-së së Bashkisë Elbasan, pasi sheshi i ndërtimit është miratuar 1033 m². Regjistrimi i sipërfaqes së sheshit të ndërtimit më pak se vendimi i KRRT-së, veprime këto në mospërputhje me neni 46, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe pikën 12.1, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 20/213, volum 23, faqe 239, ZK 8525, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

12- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 4 raste, ka bërë regjistrimin e pallateve të EKB, me dokumentacion të fotokopjuar dhe të pa noterizuar, veprime këto në mospërputhje me nenin 49, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të VKM nr. 1025, datë 09.07.2008 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 16/94, volum 23, faqe 66; pasurinë nr. 13/68, volum 24, faqe 20; pasurinë nr. 13/65, volum 24, faqe 14; pasurinë nr. 18/35, volum 24, faqe 53, ZK 8525, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

13- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 6 raste, ka bërë regjistrimin e ndërtesave pa marrëdhënie me truallin, pa leje sheshi dhe leje ndërtimi dhe pa planvendosje të miratuar nga KRRT-ja, veprime këto në mospërputhje me neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe pikën 12, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 597-ND, volum 6, faqe 164, ZK 3965; pasurinë nr. 330/16-ND, volum 8, faqe 128, ZK 1258; pasurinë nr. 362/1-ND-2, volum 8, faqe 100, ZK 1258; pasurinë nr. 350/6/5-ND volum 8, faqe 177, ZK 1258; pasurinë nr. 323/4, volum 8, faqe 100, ZK 1258; pasurinë 350/10-ND, volum 8, faqe 163, ZK 1258, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

14- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 2 rast, ka bërë regjistrimin e pasurisë nr. 274/32, truall me sipërfaqe 1,260 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 64 m² në pronësi të Shtetit, duke e kaluar në pronësi të subjektit privat pa dokumentacion ligjor dhe pasurinë nr. 31/21/4, sipas lejes së ndërtimit të KRRT-së së Bashkisë Belsh, në mungesë të marrëdhënieve me truallin.

Veprimet mësipër, vijnë në mospërputhje me nenin 24/a, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me nenin 3, të ligjit nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për

shitblerjen e trojeve“ dhe pika 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për Përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 274/32, volum 4, faqe 184 dhe pasurinë nr. 31/21/4, volum 4, faqe 155, ZK 1147, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Menjëherë

15- Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 14 raste, ka regjistruar në zonën urbane të fshatit Floq, truallin dhe oborin në pronësi të poseduesit privat, ndërsa trualli duhet të ishte regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme në Seksionin “E” në “Përdorim”, veprime këto në mospërputhje me pikën ”a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me pikën 12.1, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 ”Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar dhe nenin 10, të Dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë sipas pasqyrës në Raportin Përfundimtar të Auditimit, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

16- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 5 raste, ka bërë regjistrimin e apartamenteve të EKB, në mungesë të certifikatës së gjendjes familjare datë 01.12.1992, për të përcaktuar bashkëpronaret me moshë mbi 18 vjeç, veprime këto në mospërputhje me pikën 8.4, Kreu i IV, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 ”Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë sipas pasqyrës në Raportin Përfundimtar të Auditimit, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

17- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 2 raste, ka bërë regjistrimin e truallit me sipërfaqe totale **248 m²** pa patur kontratë shitëblerje, veprime këto në mospërputhje me shkronjën “a”, të nenit 25 e 42, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 12/234, volum 24, faqe 150 dhe pasurinë nr. 29/234, volum 26, faqe 21, ZK 8525, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

18- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në një rast, ka bërë regjistrimin e truallit me sipërfaqe **37 m²** pa dokumentacion pronësie, veprime këto në mospërputhje shkronjën “a” neni 25, të ligjin nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 22/252, volum 26, faqe 123, ZK 8525, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

19- Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Elbasan ka bërë regjistrimin e pasurisë nr. 5/224, ndërtesë me sipërfaqe 37,90 m², me dokumentacion të fotokopjuar dhe pa noterizuar, si dhe duke regjistruar më shumë se dokumentacion i pronësisë truall me sipërfaqe **39,10 m²**, veprime këto në mospërputhje me shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” dhe Rregulloren nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 5/224, volum 25, faqe 161, ZK 8522, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

20- Gjetje nga auditimi: Nga ZVRPP Elbasan në 18 raste, ka bërë regjistrimin e ndërtesave sipas nenit 25/b, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, ndërsa regjistrimi i pasurive të paluajtshme sipas nenit 25/b, bëhet kur në dokumentacionin përkatës janë përcaktuar kufizimet dhe nuk është përcaktuar sipërfaqja e truallit, veprime këto në mospërputhje me paragrafin 3 shkronja “b” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe me pikën 5, të VKM nr. 745, datë 24.10.2012 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen” dhe Rregulloren nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë sipas pasqyrës në Raportin Përfundimtar të Auditimit, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

21- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 6 raste, ka bërë regjistrimin e ndërtesave pa deklaratën noteriale të kufitarëve, në mungesë të dokumenteve nga arkivi teknik i ndërtimit, pa patur konfirmimin nga njësitë administrative vendore dhe pa patyur procesverbalin e komisionit të ZVRPP për mbylljen e procesit të afishimit publik, veprime këto në mospërputhje me paragrafin 3 shkronja “b” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronja “c” dhe “ç” pika 4, 7 dhe 8, të VKM nr. 745, datë 24.10.2012 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë sipas pasqyrës në Raportin Përfundimtar të Auditimit, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

22- Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 4 raste, ka bërë regjistrimin e pasurive pa deklaratat personale të pronarëve të truallit, ndërsa deklaratat noteriale të kufitarëve në kufizime nuk përputhen me planrilevimet e hartuara nga topografi me licencë, veprime këto

në mospërputhje me neni 24/b, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr. 745, datë 24.10.2012 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen” dhe kreu IV, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 11/21, volum 25, faqe 194; pasurinë nr. 11/387, volum 25, faqe 219; pasurinë nr. 10/296, volum 25, faqe 223; pasurinë nr. 9/280, volum 25, fq. 230, ZK 8522, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

23- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 30 raste, ka bërë regjistrimin e lejeve të legalizimit kontratë (Shitje me Rezervë e pronës), ndërsa shitje me rezervë e pronës është akti, i cili përmban kufizime të tagrave dhe të të drejtave të pronarit të pasurisë së paluajtshme, veprime këto në mospërputhje me nenin 49, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 5111/3, datë 28.08.2012, të Kryeregjistruesit për regjistrimin e pasurive të fituara sipas ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë sipas pasqyrës në Raportin Përfundimtar të Auditimit, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

24- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 11 raste, ka bërë regjistrimin e lejeve të legalizimit pa ortofoton digjitale, veprime këto në mospërputhje me nenin 49, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 5111/3, datë 28.08.2012, të Kryeregjistruesit për regjistrimin e pasurive të fituara sipas ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë sipas pasqyrës në Raportin Përfundimtar të Auditimit, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

25- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 4 raste, ka bërë regjistrimin e pasurive të paluajtshme me sipërfaqe total 842.50 m² trualli dhe ndërtesa duke ndryshuar zërin kadastral nga “**liqen**” në zërin kadastral “**truall**”, si dhe bashkëlidhur dokumentacionit nuk ndodhen “Ortofotot digjitale”, veprime këto në papajtueshmëri me nenin 25/a të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, në papajtueshmëri me pikën 2, të UKM nr. 2 datë 12.9.2012 “Për Përcaktimin e Elementeve të Akteve, që verifikohen nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të Regjistruesit”, Kapitulli I, të Udhëzimit të Kryeregjistruesit nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituar me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 dhe me nenin 2 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 për “Legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, nenin 55/b i ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996 “Për Rezervat Ujore”, të ndryshuar, dhe pikën 3/iii të VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për Përcaktimin e Kriteve, të Procedurave dhe Dokumentacionit të Zbatueshëm, për të Kualifikuar Objektet në Ndërtim, që Legalizohen ose jo”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 30/39, volum 4, faqe 157; pasurinë nr. 30/36, volum 4, faqe 159; pasurinë nr. 30/38, volum 4, faqe 158; pasurinë nr. 30/43, volum 4, faqe 151, ZK 1147, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Menjëherë

26- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 30 raste, ka bërë regjistrimin e lejeve të legalizimit me kontratë (Shitje me Rezervë e pronës), ndërsa shitje me rezervë e pronës është akti, i cili përmban kufizime të tagrave dhe të drejtave të pronarit të pasurisë së paluajtshme, veprime këto në mospërputhje me nenin 49, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 5111/3, datë 28.08.2012, të Kryeregjistruesit për regjistrimin e pasurive të fituara sipas ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë sipas pasqyrës në Raportin Përfundimtar të Auditimit, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Menjëherë

27- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 13 raste, ka bërë regjistrimin e lejeve të legalizimit pa ortofoton digjitale, veprime këto në mospërputhje me nenin 49, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 5111/3, datë 28.08.2012, të Kryeregjistruesit për regjistrimin e pasurive të fituara sipas ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë sipas pasqyrës në Raportin Përfundimtar të Auditimit, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Menjëherë

28- Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Elbasan, ka bërë regjistrimin e pasurisë nr. 177/116, truall me sipërfaqe 244,80 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 78,90 m² në mungesë të kontratës së kalimit të parcelës ndërtimore, ndërsa me urdhër të Regjistruesit ndërtesa është **“Fshirë”**, duke kaluar në pronësi të Hyqmet Aqif Plaka, sipas procedurës së ALUIZNI-it.

Regjistrimin e pasurisë nr. 148/72, truall me sipërfaqe 451,60 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 237,70 m² në pronësi të Shtetit, ndërsa me urdhër të Regjistruesit ndërtesa është **“Fshirë”**, duke kaluar në pronësi të Mehmet Shaqir Plaka, sipas procedurës së ALUIZNI-it.

Regjistrimin e pasurisë nr. 148/73, truall me sipërfaqe 295,80 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 149,10 m², në pronësi të Shtetit, ndërsa me urdhër të Regjistruesit ndërtesa është **“Fshirë”**, duke kaluar në pronësi të Oligert Mehmet Plaka, sipas procedurës së ALUIZNI-it.

Fshirja e ndërtesave në pronësi të Shtetit, duke i kaluar ato në pronësi të subjekteve private pa i privatizuar, vijnë në mospërputhje me nenin 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 93, 163, 193, Rregullore nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurisë të paluajtshme”, të ndryshuar dhe Udhëzimit të ZQRPP nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të fituara sipas ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave ndërtimore informale”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të

Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 177/116, volum 9, faqe 181; pasurinë nr. 148/72, volum 10, faqe 8 dhe pasurinë nr. 148/73, volum 10, faqe 16, ZK 1820, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

29- Gjetjet nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 2 raste, KPP i ka mbyllur dhe nuk përcaktojnë në cilin volum dhe faqe vijon, kartelat nuk janë mbyll me vulë mbyllëse.

Në 2 rate toka arë me sipërfaqe **842 m²**, nuk e kanë regjistruar në pronësi të Shtetit, si dhe duke bërë ndryshimin e zërit kadastral nga arë në truall, veprime në mospërputhje me neni 25/a, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme”, Rregulloren nr. 184, datë 04.08.1999 ”Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar dhe Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999 ”Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 207/10, vol 2, faqe 50 dhe pasurinë nr. 131/41, volum 4 faqe 167, ZK 1820, deri në plotësimin saktë të kartelave të pasurisë së paluajtshme.

Brenda muajit Shkurt 2015

30- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në një rast, ka bërë regjistrimin e Banesës 2 kt, sipas vendimit nr. 1, datë 08.05.2009, të KRRT-së të Komunës Gostinë, në mungesë të *marrëdhënive me truallin*, veprime këto në mospërputhje me neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe pikën 12, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 ”Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Elbasan të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 82/8/4, volum 12, faqe 169, ZK 2529, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Brenda muajit Shkurt 2015

31- Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i ankesës së z. Flamur Harri, është konstatuar se ZVRPP Elbasan, nuk ka vlerësuar dhe trajtuar në mënyrë të hollësishme dhe të përgjegjshme, disponimet dhe dokumentet ligjore që ka mbi objektet e gjykimit dhe vendime të gjykatës të paraqitura për regjistrim nga ankuesi e vendosjen e kufizimeve mbi pasuritë e paluajtshme të regjistruar në kundërshtim me ligjin nga persona të tjerë.

Rekomandim:

a. ZVRPP Elbasan të marrë masa dhe të rivlerësoj vendimet e gjykatave me palë ndërgjyqëse z. Flamur Harri mbi trajtimin e pasurive objekt gjykimi, veprime këto në zbatim të nenit 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

b. ZVRPP Elbasan në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruar në kundërshtim me ligjin.

Menjëherë

B. MASE PËR SHPËRBLIM DËMI

1- Gjetje nga auditimi: ZVRPP Elbasan në 7 raste, nuk ka arkëtuar shumën **19.500 lekë**, duke mos kryer aplikime për subjektet private, por duke bërë regjistrimin e pasurive në kartelën e pasurisë së paluajtshme pa aplikime, veprime këto në kundërshtim me shkronjën “a” neni 21, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr. 713, datë. 20.10.2011 “Përcaktimin e tarifave të shërbimit të ZVRPP”, të ndryshuar, me UKM nr. 5341/5, datë 07.09.2012 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të zyrave të

regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, dhe me pikën 4 kreu VI, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës **19.500 lekë nga:**

1. E.Ç. me detyrë juriste 6.500 lekë;
2. S.S. me detyrë juriste 6.500 lekë;
3. E.Gj. me detyrë jurist 6.500 lekë.

Brenda muajit Shkurt 2015

C. MASA DISIPLINORE

I- Mbështetur në nenet 37, 141, 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe nr. 9125, datë 29.07.2003, ligjin nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, si dhe në kontratën individuale të punës, kërkojmë nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, për 11 punonjësit si më poshtë:

C. 1. “Vërejte me paralajmërim”, për:

1. **A.P.** me detyrë juriste
2. **E.I.** me detyrë juriste
3. **M.T.** me detyrë inxhinier (hartograf)
4. **E.Gj.** me detyrë jurist
5. **E.D.** me juriste
6. **F.K.** me detyrë jurist
7. **G.D.** me detyrë jurist
8. **E.E.** me detyrë hartograf
9. **A.Sh.** me detyrë z/Regjistruues
10. **S.S.** me detyrë juriste.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në regjistrimin fillestar dhe veprimeve të tjera të pasurive të paluajtshme, me nenin 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”, UKM nr. 2, datë 08.04.2009 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP)”, Rregulloren nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, Udhëzimin nr. 2532, datë 21.04.2009 të Kryeregjistruesit “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituar me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale”. Mos verifikimi i dokumentacionit të përcjell nga ALUIZNI,

C. 2. “Zgjidhje të kontratës individuale të punës”, për:

1. A.K. me detyrë jurist.

Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 33, datë 29.4.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, UKM nr. 1, datë 31.07.2007 dhe UKM nr. 2, datë 12.9.2012 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, kapitullin e I, të Udhëzimit të Kryeregjistruesit nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme...” dhe të Rregullores për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999 të ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në regjistrimin fillestar dhe veprimeve të tjera të pasurive të paluajtshme, sipas trajtimit në procesverbale dhe në kapitujt përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit të paraqitur për ZVRPP Elbasan, si mëposhtë:

1. Për regjistrimin e pasurisë nr. 177/116, truall me sipërfaqe 244,80 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 78,90 m², e kanë bërë në mungesë të kontratës së kalimit të parcelës ndërtimore, ndërsa me urdhër të Regjistruesit ndërtesa është **“Fshirë”**, duke kaluar në pronësi të H.P. sipas procedurës së ALUIZNI-it.

2. Për regjistrimin e pasurisë nr. 148/72, truall me sipërfaqe 451,60 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 237,70 m², në pronësi të Shtetit, ndërsa me urdhër të Regjistruesit ndërtesa është **“Fshirë”**, duke kaluar në pronësi të M.P. sipas procedurës së ALUIZNI-it.

3. Për regjistrimin e pasurisë nr. 148/73, truall me sipërfaqe 295,80 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 149,10 m², në pronësi të Shtetit, ndërsa me urdhër të Regjistruesit ndërtesa është **“Fshirë”**, duke kaluar në pronësi të O.P. sipas procedurës së ALUIZNI-it. Fshirja e ndërtesave në pronësi të Shtetit duke i kaluar ato në pronësi të subjekteve private pa i privatizuar, vijnë në mospërputhje me nenin 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 93, 163, 193, Rregullore nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurisë të paluajtshme”, të ndryshuar dhe Udhëzimit të ZQRPP nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të fituara sipas ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave ndërtimore informale”, të ndryshuar.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan:

1. **R.P.** me detyrë ish-Regjistruese
2. **J.V.** me detyrë jurist
3. **Z.I.** me detyrë hartograf
4. **A.K.** me detyrë jurist.

Nga ZVRPP Elbasan, me shkresë nr. 4555/2, prot, datë 20.01.2015, protokolluar në KLSH me nr.767/17 datë 31.01.2015, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Qemal Shehu, Julian Adili dhe Josif Lile dhe më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT